

REPUBLIKA E KOSOVES
ASSEMBLY OF MUNICIPALITIES
SKENDERAJ
09-060/09-0014283/26
Data
22-04-2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe në pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu - Alija:

T H È R R E T

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 30.04.2026, (ditë e enjte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE

1. Fjala hyrëse,
2. Miratimi i rendit të ditës,
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara,
4. Shqyrtimi i raportit financiar janar – mars 2026, (raporton Drejtori i DBF, z Behxhet Maliqi),
5. Propozim – Vendim për rishqyrtimin e vendimin për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, Komuna Skenderaj, (raporton Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku),
6. Propozim – Vendim për rishqyrtimin e vendimin për miratimin e planit zhvillimor komunal 2026 – 2034, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku),
7. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

KRYSUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu-Alija





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverballi i **MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,**
i datës **07.04.2026,** ora **10:00**

REND DITE

1. Fjala hyrëse,
2. Miratimi i rendit të ditës,
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara,
4. Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.09-020/01-0010900/26, i datës; 26.03.2026, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve për muajin jaran 2026, dëme të shkaktuara në bujqësi, ekonomi familjare, biznese dhe vetura në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale 532,666.96 Euro,(raporton Kryetari i Komisionit z. Hajzer Shala),
5. Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.06-325/04-0011275/26, i datës; 30.03.2026, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë publike si pasojë e vërshimeve të muajit jaran 2026, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale 2,014,930.00 Euro,(raporton Kryesuesja e Komisionit znj. Sanije Ahmeti),
6. Propozim – Vendim për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit nr. 01-020/01-008208/26, të datës; 03.03.2026, të miratuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Skenderajt të datës; 27.02.2026, përkitazi me procedurën e formimit të komitetit për politik dhe financa,(raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. Adelina Spahiu – Alija),
7. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Përshëndetje i nderuar Kryetar i Komunës së Skenderajt z. Sami Lushtaku, i nderuari Nënkyetar z. Fadil Nura, te nderuar përfaqësues të OSBE-së, Mapl, anëtar të Kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe ju te gjithë te pranishmit, te pranishëm në sallë i kemi 24 anëtar, mungon me arsye Armir Sejdiu, mungon me arsye Kushtrim Dragaj, mungon me arsye Abdullah Gashi, vazhdojmë me piken e radhës miratimi i rendit të ditës e hap diskutimin, pasi nuk ka për diskutim, shkojmë me votim, konstatojmë se me 18 vota për, 0 kundër dhe 2 abstenime miratohet rendi i ditës, vazhdojmë me piken e radhës shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap diskutimin, pasi që nuk ka për diskutim shkojmë me votim, konstatojmë se me 24 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverballi nga mbledhja e kaluar, vazhdojmë me piken e 4 Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.09-020/01-0010900/26, i datës; 26.03.2026, i hartuar nga komisioni komunal për

vlerësimin e dëmeve si pasoj e vërshimeve për muajin jaran 2026, dëme të shkaktuara në bujqësi, ekonomi familjare, biznese dhe vetura në territorin e Komunës së Skenderajt, ne vlerë totale 532,666.96 Euro,(raporton drejtori i shërbimeve publike z. Arber Geci).

Arber Geci DSHP - Përshëndetje për të gjithë, i nderuari Kryetar, Nënkyetar dhe ju te gjithë te pranishmit, ne bazë te rregullores nr 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit te dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, sipas kërkesave te qytetareve te dëmtuar nga dëmet e shkaktuara te muajit janar 2026, komisioni i formuar me vendim te Kryetarit te Komunës ka pranuar te gjitha kërkesat e qytetareve ka dal ne teren ku kanë qenë 159 kërkesa te dëmeve ne ekonomi familjare, 75 dëme fermerëve ne bujqësi 15 dëme ne bujqësi dhe 10 vetura qe gjithsej 259 ne total janë refuzuar 58, nga demet me te mëdha janë ne ekonomi familjare dhe bujqësi ju rekomandoj qe ta miratoni e me pastaj te dërgohen ne AME për procedura te mëtutjeshme, nëse keni pyetje jam i gatshëm për përgjigjeje.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit drejtor, e hap diskutimin.

Afrim Kabashi, NSD - Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, unë besoj se komisioni e ka kry punën e vete mire, çdo pune te mire qe është ne dobi te qytetarëve e kam përkrah dhe do ta përkrahi, vota ime është pro këtij propozimi.

Nezir Bejta, LVV – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, kisha kërkuar një sqarim lidhur me këto data ne raport te urbanizmit, bazuar ne komisionin e datës 18.12.2025 për vlerësimin e dëmeve si pasoj e vërshimeve te datës 06.01.2026, pse ky komision është formuar para se te ndodhin vërshimet, pastaj shihet se këto raporte janë te pa detaizune, kush janë te dëmtuar, pak ka informata lidhur me këto propozim – vendime.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Prof ky raport qe po e përmend është, pikë tjetër e rendit te ditës.

Nezir Bejta, LVV –Ne rregull, mirëpo shihen propozime raporte jo te detaizuara mire, nuk ka te dhëna qe sqarojnë saktë, pastaj një arë është këtu tek raporti i infrastrukturës kisha kërku sqarim, pastaj tek lumi klina ka dallim tek vlera e vlerësimit te demit, ne këtë raport shihet se është vlerësuar me pak kur e dimë sa është bere dëme, pastaj ne liste ka qene palestra Ilaz Kodra si e vërshuar e e dimë se atë pjese nuk ka qene e vërshuar.

Arber Geci, DSHP – Prof Ligji për mbrojtjen e te dhënave personale nuk kemi te drejte te publikojmë te dhënave personale dhe nuk është praktikuar as me herët qe te publikohen te dhënat personale.

Hysni Mehani, LVV – Përshëndetje për të gjithë, profa i trajtoj te dy rastet pasi qe si fenomen është i njëjtë, ky raport ka qene dashur te jete me i detajuar me i kompletuar, nuk është ajo çfarë tha drejtori se nuk na lejoj ligji për mbrojtjen e te dhënave personale, sepse unë për çështjet e natyrës se njëjtë kam kërkuar qasje ne dokumente në AME dhe me i kanë ofruar te kompletuar me te dhëna raportin e dëmeve, prandaj nuk këtu nuk ka transparenc fare, pse po i fshehni këto raporte me te dhëna.

Nënkyetari z. Fadil Nura –Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, vetëm sa për sqarim shtese autoritet i vetëm për vlerësim te këtyre raporteve te komisionit për vlerësim te dëmeve është vetëm AME-ja, ata munden me kerku dokumente shtese, me ardh vete ne vende ku janë vërshuar nga fatkeqësitë natyrore, ndërsa tek çështja se pse është vlerësuar me pak kësaj here demi tek lumi klina qendror ne atë sepse kemi investuar ne atë pjese dhe për këtë arsye janë demet me te vogla kësaj here.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija: Faleminderit, pasi qe nuk kemi tjerë për diskutim ne lidhur me këtë propozim – vendim, konstatojmë se me 19 vota për, 0 kundër dhe 4 abstenim miratohet Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.09-020/01-

0010900/26, i datës; 26.03.2026, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve për muajin jaran 2026, dëme të shkaktuara në bujqësi, ekonomi familjare, biznese dhe vetura në territorin e Komunës së Skenderajt, ne vlerë totale 532,666.96 Euro, vazhdojmë me piken e radhës, Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.06-325/04-0011275/26, i datës; 30.03.2026, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë publike si pasojë e vërshimeve të muajit jaran 2026, në territorin e Komunës së Skenderajt, ne vlerë totale 2,014,930.00 Euro,(raporton Kryesuesja e Komisionit znj. Sanije Ahmeti).

Sanije Ahmeti, Kryesuese e komisionit – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, sa i përket gabimit ne raport që e ngritët e kemi rregulluar ka qene gabim teknik, mirëpo nuk qenka këtu ne material nuk e di pse, ndërsa sa i përket këtij raporti, komisioni i zgjedhur me vendim te kryetarit ka trajtuar te gjitha kërkesat për dëme ne infrastrukturë publike ka dale ne teren dhe i ka vlerësuar, vlera totale e dëmeve ne infrastrukture publike është 2.014., 930.00€, te gjitha i keni ne material raportin si dhe listën e kërkesave te qytetareve, nëse keni pyetje jam për tu përgjigjur.

Afrim Kabashi, NSD - Faleminderit Kryesuese, ne raport shihet se i mungojnë numrat e telefonit si dhe te dhënat tjera personale te paraqitsave te kërkesave.

Nezir Bejta, LVV – Po e përsëriti prape pse këtu tek raporti i infrastrukturës publike është futur një arë është ndonjë gabim apo çfarë.

Sanije Ahmeti, Kryesuese e komisionit – Për çështje te arës, është ceduar nga bujqësia dhe e ka vlerësuar nga komisioni.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija: Pasi që tjerë nuk ka për te diskutuar, shkojmë ne votim, konstatojmë se me 19 për , 0 kundër dhe 4 abstenim, miratohet Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.06-325/04-0011275/26, i datës; 30.03.2026, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë publike si pasojë e vërshimeve të muajit jaran 2026, në territorin e Komunës së Skenderajt, ne vlerë totale 2,014,930.00 Euro, vazhdojmë me piken e radhës Propozim – Vendim për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit nr. 01-020/01-008208/26, të datës; 03.03.2026, të miratuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Skenderaj të datës; 27.02.2026, përkitazi me procedurën e formimit të komitetit për politik dhe financa, për këtë propozim raporton Kryesuesja unë ne këtë raste, propozim – vendimi ka te bejë me rishqyrtimin e vendimit lidhur me formimin e komitetit për politik dhe financa i miratuar me datën 27.02. 2026 ku MAPL ka kërkuar që te respektohet kuota gjinore duke zëvendësuar një nga gjina mashkullore me femërore, andaj kërkoj që ta bëjmë këtë zëvendësim, e hap diskutimin.

Alban Berisha, PDK – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, ne bazë të rekomandimeve të MAPL-së që do ta respektojmë pavarësisht se është vlerësim politik por ne do ta respektojmë, propozoj që ta zëvendësojmë Dardan Shalen me Arlinda Halili ne mënyrë që ta funksionalizojmë kpf, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija: Faleminderit Alban, si procedurë na u duhet te shkojmë ne votim për largimin e Dardan Shales nga kpf, konstatojmë se me 16 për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet largimi i Dardan Shales nga kpf-ja, shkojmë ne votim për hyrjen ne kpf te Arlinda Haliti, konstatojmë se 19 për, 0 kundër dhe 0 abstenim Arlinda Haliti merr votat e mjaftueshëm për te qene pjesë e kpf-së, tash shkojmë me votim ne tersi te propozim vendimin per rishqyrtimin e vendimit për formimin e kpf, konstatojmë se me 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim – Vendim për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit nr. 01-020/01-008208/26, të datës; 03.03.2026, të miratuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Skenderaj të

datës; 27.02.2026, përkitazi me procedurën e formimit të komitetit për politik dhe financa, vazhdojmë me piken e radhës Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

Arlinda Haliti, PDK –Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë po i lexoj pyetjet e parashtruara për këtë seancë Pyetje ime e parë është për drejtorin e DSHP-së, z.Arber Geci. I nderuar drejtor, pyetja ime ka të bëjë me ndriçimin në rrugën “Azem Bejta”. Mungesa e ndriçimit si dhe mosfunksionimi i semaforëve në atë rrugë që sa herë po sjellë aksidente që fatkeqësisht po përfundojnë me fatalitet. Rastin më të freskët e kemi atë të datës 17 mars që për pasojë pati vdekjen e një këmbësori teksa po kalonte rrugën. E di që ndriçimi në këtë rrugë nuk është në kompetencë të komunës, por ajo që po më intereson është nëse e keni adresuar si kërkesë në ministrinë përkatëse që të ketë veprime konkrete në mënyrë që të parandalohen aksidentet, dhe qytetarëve që banojnë ose kalojnë nga ajo lagje t’u ofrohet siguria e nevojshme. Pyetja ime e dytë është për drejtorin e DKA-së, z.Kastriot Duraku. Drejtor, këto ditë nga disa nxënës të gjimnazit “Hamëz Jashari” kam pranuar një shqetësim. Kabineti për lëndët kimi dhe biologji si dhe kabineti i lëndës së fizikës janë ende pa banka dhe pa karriga, dhe kësaj mbajtja e pjesës praktike të këtyre lëndëve po bëhet e pamundur, gjë që e lë të mangët mësimnxënien. E di që kontrata ka skaduar, por kur pritet që të keni një kontratë aktive, kur supozohet që kabinetet të pajisen me banka dhe karriga në mënyrë profesorët dhe nxënësit e kësaj shkolle të fillojnë ta zhvillojnë praktikën. Faleminderit

Arber Geci, DSHP – Faleminderit për pyetjet Arlinda, ke punu ne Komunë e dinë se për semaforë kompetencë është ministria, dhe Komuna vazhdimisht ka bere kërkesë për semaforë ne Ministri, mirëpo po e neglizhojnë e po na ndodhin aksidente me fatalitet në atë pjesë, do te bënte zgjedhje te rregullohet rreth rrotullim e qe o presim nga ta pasi qe është kompetencë e tyre.

Kastriot Duraku, DKA- Faleminderit për pyetjet, furnizimi me inventar ajo kontrate është ne procedurë ne AQP, mirëpo ne gjate pushimit ne Shkolla e kemi furnizuar Gjimnazin me banka dhe karriga ne klasat ku ka pasur mungesë.

Nezir Bejta, LVV- Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, po i lexoj pyetjet e parashtruara për këtë seancë Për: ekzekutivin e komunës Si e arsyeton ekzekutivi i komunës së Skenderajt lidhjen e një kontrate 35-vjeçare për ndërtimin e stacionit të autobusëve në tokën komunale, ku kompania private përfiton 70% të tarifave të operimit, ndërsa komuna vetëm 30%, pa marrë qira për tokën dhe pa përfituar asgjë nga lokalet e shumta brenda stacionit të autobusëve? A nuk e konsideron ekzekutivi se një marrëveshje e tillë e dëmton interesin publik dhe pronën komunale, dhe mbi çfarë analize financiare është marrë ky vendim? Sipas llogaritjeve të komunës sa është përfitimi vjetor i komunës për dhënien e kësaj prone?

Nënkryetari z. Fadil Nura – Faleminderit Kryesuese, e pash si te nevojshme ti japi disa sqarime sa i përket pyetjeve të profës, sa i përket stacionit te autobusëve e dimë se ne çfarë gjendje kemi qene deri tash, nuk kemi pasur stacion fare, tash kemi një stacion modern pa investu Komuna asnjë cent në të, asnjë investitor nuk vije me investu atu pa e pasur një llogari, duke e dite se aj atu ka me i mbulu komplet shpenzimet si te rrymës, ujit, stafit atu, e qe po besoj si për komunën do ishte një barre e madhe një investim i tillë diku 2 milion Euro si dhe mbulimi i këtyre shpenzimeve, prandaj ne seancën e radhës do ju vije plotësim ndryshimi i rregullores për taksa, ngakesa dhe gjoba qe do te caktohen tarifa te reja për linje te autobusëve qe Komuna do te inkasoj 30% nga ato pagesa.

Nezir Bejta, LVV- Nënkryetar, stacioni pa dyshim se është projekt i mire askush nuk po e konteston, mirëpo duhet ta dimë vlerën e asaj prone e qe duhet te hynë ne 30% edhe nga lokalet sepse nga linjat e autobusëve pak .

Nënkryetari z. Fadil Nura – Prof prona është dhënë ne afat te caktu, nuk është shitur prona, për komunën ka qene barre e madhe një investim i tillë, 30% e merr Komuna atu pa investuar asnjë cent atu.

Burim Veliu, PDK- Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë për këtë seancë kam parashtruar këto pyete **Drejtuar:** Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Lënda: Kërkesë për intervenim në rregullimin e kanalizimit në fshatin Polac, lagjja Veliu dhe kryqëzimi pranë Xhamisë në rr. “Mulla Brahim Polaci”

I nderuar Drejtor,

Në cilësinë time si anëtar i Kuvendit Komunal të Skenderajt, njëkohësisht edhe banor i fshatit Polac, po ju drejtohem me këtë kërkesë bazuar në shqetësimet e vazhdueshme të banorëve të kësaj zone lidhur me problemet e kanalizimit.

Konkretisht, kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për rregullimin e sistemit të kanalizimit në lagjen Veliu, ku ujërat e zeza rrjedhin vazhdimisht mbi rrugë. Ky problem është i kahershëm dhe po shkakton shqetësim të madh për banorët, duke paraqitur njëkohësisht rrezik serioz për higjienën dhe shëndetin publik.

Po ashtu, shqetësuese mbetet edhe gjendja në kryqëzimin pranë Xhamisë në rrugën “Mulla Brahim Polaci”, ku gjithashtu ka rrjedhje të kanalizimit mbi rrugë, duke përkeqësuar situatën për banorët dhe kalimtarët.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij problemi për komunitetin lokal, kërkoj që drejtoria përkatëse të realizojë një inspektim të gjendjes në terren dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për zgjidhjen sa më të shpejtë të tij.

Gjithashtu, ju lutem të na informoni nëse është planifikuar realizimi i këtij projekti, si dhe për afatet e mundshme të fillimit dhe përfundimit të rregullimit të kanalizimit në këtë pjesë, në mënyrë që banorët të kenë një pasqyrë të qartë për zgjidhjen e këtij problemi.

Drejtuar: Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Lënda: Kërkesë për ndërhyrje ndaj deponisë ilegale në lagjen Veliu

I nderuar Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,

Dëshiroj të ju drejtohem lidhur me një shqetësim serioz të ngritur nga banorët e lagjes Veliu.

Në këtë zonë është krijuar një deponi ilegale, ku individë dhe kompani të ndryshme janë duke hedhur mbeturina në mënyrë të pakontrolluar. Po ashtu, kjo hapësirë më herët është shfrytëzuar nga fëmijët për aktivitete sportive, ku kanë luajtur futboll dhe volejball. Kjo situatë po shkakton ndotje të konsiderueshme të mjedisit, rrezik për shëndetin publik si dhe po cenon rëndë cilësinë e jetës së banorëve të asaj lagjeje.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij problemi, ju lus që të ndërmerrni masa urgjente për:

- Pastrimin e menjëhershëm të kësaj deponie ilegale;
- Identifikimin dhe ndëshkrimin e personave dhe subjekteve përgjegjëse;
- Vendosjen e mekanizmave parandalues për të shmangur përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

Jam i gatshëm të bashkëpunoj dhe të kontribuoj në çdo formë për zgjidhjen sa më të shpejtë të këtij problemi.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe pres angazhimin tuaj në këtë çështje

Drejtuar: Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Lënda: Propozim për lidhjen e një memorandumit bashkëpunimi ndërmjet komunës, shkollave profesionale dhe bizneseve lokale

I nderuari z. Duraku dhe i nderuari z. Geci,

Në cilësinë time si anëtar i Kuvendit Komunal të Skenderajt, kam kënaqësinë të paraqes këtë propozim për iniciimin e një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe bizneseve lokale.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është angazhimi i nxënësve të shkollave profesionale në kuadër të praktikës mësimore, në prodhimin dhe rregullimin e elementeve të ndryshme për hapësirat publike të komunës, si: shporta për mbeturina, ulëse për parqe dhe elemente të tjera funksionale për rregullimin e parqeve dhe ambienteve publike.

Gjithashtu, jam i informuar se Drejtoria e Arsimit, ndër vite, ka zhvilluar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private për realizimin e praktikës profesionale të nxënësve në profile të ndryshme, gjë që paraqet një bazë të mirë për zgjerimin e këtij bashkëpunimi edhe në këtë drejtim.

Sipas këtij modeli, bizneset lokale do të kontribuonin me sigurimin e lëndës së parë, ndërsa nxënësit do të realizonin produktet në kuadër të praktikës profesionale. Njëkohësisht, bizneset kontribuese do të mund të përfitojnë promovim përmes vendosjes së elementeve identifikuese apo reklamuese në produktet e realizuara.

Përfitimet nga realizimi i këtij bashkëpunimi do të ishin:

1. Nxënësit e shkollave profesionale fitojnë përvojë praktike dhe aftësi profesionale të dobishme për tregun e punës.
2. Komuna përmirëson dhe pasuron hapësirat publike me elemente funksionale për qytetarët.
3. Bizneset lokale promovohen dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e komunitetit.
4. Forcohet bashkëpunimi ndërmjet arsimit profesional dhe sektorit privat, duke krijuar një model të qëndrueshëm për të ardhmen.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij bashkëpunimi, propozoj që Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, në koordinim me bizneset lokale, të shqyrtojnë mundësinë e hartimit dhe implementimit të këtij memorandum bashkëpunimi.

Arber Geci, DSHP – Faleminderit Burim për pyetjet, punët e para si kam ardhur drejtor, i kam identifikuar të gjitha deponit ilegale, e jemi në vazhdimësi duke punuar në eliminimin e këtyre deponive, edhe në lagjen Veliu i kemi në proces të trajtimit të gjitha deponit.

Kastriot Duraku, DKA- Faleminderit për pyetjet Burim, jemi në implementim të marrëveshjeve të bizneseve me nxënës të Shkollave tona, në vazhdimësi kemi marrëveshje të tilla.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija: Pasi që veç i trajtuam të gjitha pikat e rendit të ditës, i mbylli punimet e kësaj seance, faleminderit.

Procesmbajtësi





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSINA



SKENDERAJ

Nr. 04-052/09-00193405/26
No. 04-052/09-00193405/26
Data 15.04.2026
Date 15.04.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



KOMUNA SKENDERAJ
2026

Raporti Financiar Janar – Mars 2026

Përmbajtja:

Raporti Përfundimtar JANAR –MARS 2026

1. KËRKESA PËR RAPORTIM.....	3
2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE...	3
3. RAPORTI I EKZEKUTIVIT TË BUXHETIT 2025 TABELA NR 1.....	4
4. TË HYRAT VETANAKE JANAR-DHJETOR 2025 TABELA NR 2.....	6
5. SHPENZIMET BUXHETORE NË NËNKATEGORI TABELA NR 3.....	7
6. SHPENZIME NË PROJEKTET KAPITALE TABELA NR 4.....	11-13
7. SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE TABELA NR 5	14

Raporti Financiar Janar-Mars 2026

Kërkesat për raportim

Raporti Financiar Komunal për periudhën Janar – Mars 2026, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe në bazë të “Ligjit Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë 03/L-048” dhe Statutit Komunal.

Raporti Financiar Komunal ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Përiudha e raportimit karakterizohet me faktin se:

- të gjitha mjetet e pa shpenzuara nga viti 2025 përmes procedurave të bartjes sipas rregullores financiare do të barten në vitin 2026 për të gjitha kategoritë përjashtuar atë të pagave dhe

- me vendime gjyqësore/përmbartimore në emër shtesave (shujtat, licencimi, inflacioni etj.) bazuar në kontratën kolektive për mësimdhënës të arsimit para universitar dhe për operatorë ekonomik, nuk janë realizuar asnjë pagesë në TM1-2026. Në kuadër të këtyre shpenzimeve MFPT ka krijuar një kod të ri ekonomik (00040), të ndarë për vendime gjyqësore dhe ka minusuar buxhetin total të planifikuar në këtë vit në Fondin e Bashkëfinancimit, dhe një pjesë tek projektet kapitale. Por nga këto ende nuk janë realizuar pagesa.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Buxheti i aprovuar për vitin 2026 ishte 20,245,396.00 € por në TM1 nuk rezulton me ndryshime, sepse nuk janë realizuar pagesat e vendimeve gjyqësore dhe bartja e mjeteve të pashpenzuara të vitit 2025 nuk është bërë ende.


Kategoritë ekonomike	B. fillestar	B. aktual
Pagat dhe Shtesat	12,472,426.00	12,472,426.00
Mallrat dhe Shërbimet	3,181,121.00	3,181,121.00
Shërbimet Komunale	291,900.00	291,900.00
Subvencionet	1,190,000.00	1,190,000.00
Investimet Kapitale	3,109,949.00	3,109,949.00
Rezerva	-	-
Gjithsej	20,245,396.00	20,245,396.00

Tabela nr. 1

FONDËT BURIMORE	Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Shpenzimet (pagesat) 2026	Shpenzimet (pagesat) 2025	% e Realizimit 3/2
0	1	2	3	4	5
GRANTI I PERGJITHSHËM	18,504,485.00	18,504,485.00	5,251,754.54	18,893,227.12	28.38
Pagat dhe Shtesat	12,472,426.00	12,472,426.00	4,108,208.83	11,800,066.30	32.94
Mallrat dhe Shërbimet	2,883,675.00	2,883,675.00	772,585.25	2,704,250.00	26.79
Shërbimet Komunale	291,900.00	291,900.00	138,349.48	285,677.00	47.40
Subvencionet	1,095,000.00	1,095,000.00	150,877.00	1,048,451.00	13.78
Shpenzimet Kapitale	1,761,484.00	1,761,484.00	81,733.98	3,054,782.82	4.64
Rezerva					
TË HYRAT VETANAKE Aktuale	1,740,911.00	1,740,911.00	-	1,514,420.04	0.00
Pagat dhe Shtesat					
Mallrat dhe Shërbimet	297,446.00	297,446.00		123,615.00	0.00
Shërbimet Komunale					
Subvencionet	95,000.00	95,000.00		77,012.52	0.00
Shpenzimet Kapitale	1,348,465.00	1,348,465.00		1,313,792.52	0.00
Rezerva					
TË HYRAT E BARTURA		-	-	193,700.18	
Pagat dhe Shtesat					
Mallrat dhe Shërbimet				90,772.54	#DIV/0!
Shërbimet Komunale					
Subvencionet				30,000.00	#DIV/0!
Shpenzimet Kapitale				72,927.64	#DIV/0!
DONACIONËT		-	-	-	
Pagat dhe Shtesat					
Mallrat dhe Shërbimet					
Shërbimet Komunale					
Subvencionet					
Shpenzimet Kapitale					
HUAMARRJA E JASHTME					
Pagat dhe Mëditjet					
Mallrat dhe Shërbimet					
Shërbimet Komunale					
Subvencionet					
Shpenzimet Kapitale					
GJITHSEJ K.EKONOMIKE	20,245,396.00	20,245,396.00	5,251,754.54	20,601,347.34	25.94
Pagat dhe Shtesat	12,472,426.00	12,472,426.00	4,108,208.83	11,800,066.30	32.94
Mallrat dhe Shërbimet	3,181,121.00	3,181,121.00	772,585.25	2,918,637.54	24.29
Shërbimet Komunale	291,900.00	291,900.00	138,349.48	285,677.00	47.40
Subvencionet	1,190,000.00	1,190,000.00	150,877.00	1,155,463.52	12.68
Shpenzimet Kapitale	3,109,949.00	3,109,949.00	81,733.98	4,441,502.98	2.63
Rezerva					
GJITHSEJ K.EKONOMIKE	20,245,396.00	20,245,396.00			

Grafikisht:

Raporti i shpenzimeve Janar-Mars krahasuar me buxhetin aktual 2026



Ky raport paraqet një përmbledhje të detajuar dhe analizë profesionale të realizimit të buxhetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2026, bazuar në të dhënat e paraqitura në Tabelën nr. 1. Analiza përfshin krahasimin ndërmjet buxhetit fillestar, buxhetit aktual dhe nivelit të realizimit të shpenzimeve për tremujorin e parë (TM1), si dhe krahasimin me vitin paraprak 2025.

Buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2026 është në vlerë prej 20,245,396.00 €, i cili mbetet i pandryshuar ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij aktual. Deri në fund të TM1 2026, shpenzimet e realizuara arrijnë në 5,251,754.54 €, që përfaqëson një nivel realizimi prej 25.94% të buxhetit total.

Nga kategoria e grantit të përgjithshëm, në vlerë prej 18,504,485.00 €, janë realizuar shpenzime në shumën 5,251,754.54 €, që përbën 28.38% të realizimit. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për paga dhe shtesa paraqesin realizim prej 32.94%, mallrat dhe shërbimet 26.79%, ndërsa shërbimet komunale kanë nivel më të lartë realizimi prej 47.40%. Subvencionet dhe veçanërisht shpenzimet kapitale paraqesin nivele më të ulëta realizimi në këtë fazë të vitit.

Të hyrat vetanake të komunës për vitin 2026 janë planifikuar në vlerë prej 1,740,911.00 €. Gjatë TM1 2026 nuk ka shpenzime nga kjo kategori, për shkak se nuk është bërë alokimi i të hyrave në tremujorin e parë. Kjo ndërlidhet me faktin se pjesa më e madhe e të hyrave vetanake është planifikuar në kategorinë e investimeve kapitale.

Gjatë kësaj periudhe, komuna ka operuar me kufizimin buxhetor 1/12, pasi Ligji i Buxhetit për vitin 2026 nuk ka qenë ende i aprovuar. Si pasojë e mungesës së aprovimit të buxhetit, nuk janë lejuar pagesat në kategorinë e investimeve kapitale, duke ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e ulët të realizimit të kësaj kategorie.

Nga të hyrat bartura, në vitin 2025 janë evidentuar shpenzime në vlerë prej 193,700.18 €, ndërsa për TM1 2026 nuk është bërë ende bartja e të hyrave të pashpenzuara nga kjo kategori.

Në përgjithësi, niveli i realizimit të buxhetit në TM1 2026 vlerësohet si rezultat i kushteve të përkohshme financiare dhe procedurale, veçanërisht mungesës së aprovimit të buxhetit dhe kufizimeve ligjore për shpenzime kapitale. Me aprovimin e buxhetit dhe alokimin e plotë të mjeteve, pritet përshpejtim i realizimit të projekteve kapitale dhe rritje e nivelit të përgjithshëm të shpenzimeve në periudhat në vijim.

Tabela nr.2

Nr.	Përshkrimi	Kodi	Uniraf	JANAR	SHKURT	MARS	GJITHSEJ
I	Administrata dhe personeli	16323		3,120.00	2,704.00	2,591.00	8,415.00
1	Çertifikatë lindjeje	50013	SKO4N	281.00	202.00	213.00	696.00
2	Çertifikatë kurorëzimi	50014	SKO4P	230.00	103.00	142.00	475.00
3	Çertifikatë vdekjeje	50015	SKO4Q	222.00	143.00	269.00	634.00
4	Çertifikatë – vërtetime të tjera ofiqarike	50016	SKO4R	2,375.00	2,240.00	1,955.00	6,570.00
5	Taksa administrative	50019	SKQ1T	12.00	16.00	12.00	40.00
6	Pjesëmarrja në tender	50020	SKB4Z				
7	Sigurimi i automjeteve	50109	SKQ5Z				
8	Shitja e pasurisë komunale	50413	SKQ8T				
9	0	0					
II	Buxheti dhe Financat	17523		16,959.94	13,228.79	12,754.41	42,943.14
1	Tatimi në pronë	40110	SKB2K	8,409.94	5,626.79	5,046.41	19,083.14
2	Taksa për regjistrimin e automjeteve	50001	SKBRA	8,430.00	7,490.00	7,575.00	23,495.00
3	Taksa për regjistrimin e trashigimisë – pronës	50019	SKB4L				
4	Taksat për vërtetime dhe çertifikata tjera	50011	SKBQV/SKB4R	120.00	112.00	133.00	365.00
5	Taksa Administrative	50019	SKB4U				
Zhvillimi Ekonomik - Planifikimi	48023			200.00	400.00	1,000.00	1,600.00
1	Taksa komunale në biznes	50029	SKBAH/SKEAH	200.00	400.00	1,000.00	1,600.00
2	Gjobat e biznesëve nga inspektorët financiarë	50104	SKBIF				
III	Inspeksioni	18023		40.00	1,200.00	575.00	1,815.00
1	Gjobat nga inspektorët komunal	50104	SKNIK		1,200.00	575.00	1,775.00
2	Gjobat mandatore - hudhja e mbeturinave	50114	SKMSM				
3	Taksa për pranimit teknik të lokaleve	50205	SKN6E	40.00			40.00
IV	Shërbimet Publike	18023					
1	Taksa për leje parkingu	50008	SKN4H				
2	Te hyrat nga koncesionimi i tregut të gjelbert	50417	SKM8S				
3	Shfrytëzim i pronës publike	50405	SKUBE				
4	Licencë për reklama në vende publike	50212	SKU6M				
Dona për versh. mbrenda shtetit (31)	56000						
Dona për versh. nga diaspora (32)	56000						
5	Parkingu Publik - Skenderaj	50008	SKNIK				
V	Bujqësi dhe zhvillim rural	47023		3,127.00	5.00	5.00	3,137.00
1	Nderrimi i destinimit të tokës	50012	SKT4M				
2	Taksa tjera administrative për bujqësi	50016	SKT4R	7.00	5.00	5.00	17.00
3	Shfrytëzimi i pronës publike	50405	SKT8E				
4	Participimet në bujqësi	50409	SKT8J	3,120.00			3,120.00
5	0	0					
VI	Gjeodezja, Kadastrri dhe Proha	65315		7,390.78	4,540.78	5,504.68	17,436.24
1	Trashigimia – bartja, regjistrimi i pronës	50011	SKG4L	3,030.00	820.00	1,650.00	5,500.00
2	Tax.Ndrrim i destinimit tokës	50012	SKG4M	30.00	570.00	100.00	700.00
3	Taksë për fletë-poseduese dhe kopje plani	50032	SKGFP	1,717.00	1,286.00	722.00	3,725.00
4	Taksa administrative	50019	SKG4U	157.50	127.50	127.50	412.50
5	Renta - shfrytëzimi i pronës publike	50405	SKG8E	380.00		649.90	1,029.90
6	Qiraja nga objektet publike	50408	SKG8H	1,408.28	1,408.28	1,608.28	4,424.84
7	Aktivitetet në terren për matje	50504	SKG9D	668.00	329.00	647.00	1,644.00
0	0	0					
0	0	0					
VII	Urbanizmi dhe Mbrojtja e Ambientit	66620		50.00	48,377.66	150,070.00	198,497.66
1	Lejet ndërtimore	50009	SKU4J		45,899.29		45,899.29
2	Taksat administrative	50019	SKU4J/SKU4U	50.00	30.00	70.00	150.00
3	Të hyrat nga koncesioni	50417	SKU8S			150,000.00	150,000.00
4	Taksa komunale për leje mjedisi	50045	SKULM		1,984.14		1,984.14
0	Legalizimi i Objekteve Ndërtimore	50026	SKU4J		464.23		464.23
VIII	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	73032		2,521.00	1,575.00	1,242.00	5,338.00
1	Taksa administrative DSHMS	50019	SKH4U	2,521.00	1,575.00	1,242.00	5,338.00
2	Pagesa e qeras	50408	SKHBZ				
3	0	0					
a	Shtëpia e shëndetit QKMF	74400		3,700.00	1,845.00	2,050.00	7,595.00
1	Participimi - arka	50409	SKHBJ	2,920.00	1,410.00	1,525.00	5,855.00
2	Çertifikatë mjeku	50024	SKHAC	780.00	435.00	525.00	1,740.00
0	0	0					
b	Shërbimet Sociale - QPS	75611					
1	Taksë administrative nga shërbimet sociale	50019	SKHMS				
0	0	0					
IX	Kultura, Rinia e Sporti	85023					
1	Qiraja nga objektet publike	50408	SKRBH				
2	Participimi nga KRS (biblioteka)	50409	SKRBJ				
0	0	0					
X	Arsimi – qerdhja e fëmijëve	92650		9,253.00	10,603.00	10,464.00	30,320.00
1	Shitja e shërbimeve	50401	SKF8A				
2	Qiraja nga objektet publike	50408	SKF8H				
3	Participimi për kujdesin e fëmijëve	50409	SKF8J	9,253.00	10,603.00	10,464.00	30,320.00
4	Participimi për kujdesin e fëmijëve-Bajë	50409	SKFPQ				
5	Grante nga Performanca	65000	SKBGA				
	GJITHSEJ			46,361.72	84,479.23	186,256.09	317,097.04
	Te Hyrat tjera - Gjobat nga Trafiku, Gjykata, e tjera						
1	Të hyrat nga gjobat në trafik	50101					
2	Të hyrat nga gjobat e gjykatave	50102					
3	Të hyrat nga Agjensioni pyllor e tjera	50107					
	GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE (+ provizionit)			46,361.72	84,479.23	186,256.09	317,097.04
X	Donacionet - participimi	56000	SKBGA				
	TE HYRAT + DONACIONI			46,361.72	84,479.23	186,256.09	317,097.04

Tabela nr. 2 paraqet realizimin e të hyrave vetanake të Komunës së Skenderajt për tremujorin e parë (TM1) të vitit 2026, bazuar në planifikim vjetor, realizimin faktik gjatë periudhës Janar – Mars 2026, si dhe totalin kumulativ për këtë periudhë. Raporti është përpiluar në përputhje me praktikat e raportimit financiar dhe me vendimet përkatëse institucionale.

Bazuar në të dhënat e paraqitura, të hyrat vetanake të realizuara në TM1 2026 arrijnë në gjithsej 317,097.04 €, duke reflektuar nivelin aktual të inkasimit sipas burimeve të ndryshme komunale.

Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se në këtë raport nuk janë përfshirë disa kategori të rëndësishme të të hyrave, përkatësisht:

- të hyrat nga gjobat në trafik,
- të hyrat nga gjobat e gjykatave,
- të hyrat nga agjensioni pyjor.

Këto të hyra nuk figurojnë në këtë tabelë për shkak se alokimi i tyre bëhet në muajin Prill 2026 dhe, si të tilla, nuk janë pjesë e këtij raporti që pasqyron vetëm gjendjen e realizimit për tremujorin e parë (Janar–Mars 2026).

Niveli i paraqitur i të hyrave vetanake në TM1 2026 nuk reflekton plotësisht potencialin total të të hyrave komunale për këtë vit fiskal. Me përfshirjen e kategorive të lartpërmendura në periudhat në vijim, pritjet një rritje e mëtejshme e realizimit të të hyrave vetanake gjatë vitit 2026.

Tabela nr. 3 – Analitika e shpenzimeve buxhetore në nënkategori

Kodi Ekonomik - LLOJI I SHPENZIMEVE	Total		TM1
	2024	2025	2026
11111 - Paga neto	6,068,756	9,411,773	2,456,144.84
11121 - Tatimi në të ardhurat personale	416,970	602,213	252,996.67
11131 - Kontributi pensional - punëtori	365,988	561,785	195,340.67
11151 - Sindikatat	14,963	24,241	8,550.70
11152 - Odat profesionale	5,609	7,729	5,411.60
11211 - Përvoja e punës	299,196	454,520	174,819.63
11311 - Kontributi pensional - punëdhënësi	365,988	561,785	195,340.67
11411 - Shtesa e veçant për të zgjedhurit	23,524	22,172	-
11413 - Shtesa e performancës			782,642.34
11421 - Shtesa funksionale për arsimi universitar		141	-
11431 - Kujdestaria, puna gjatë natës & puna jashtë orarit të punës	127,383	143,305	35,295.37
11611 - Shtesat tranzitore	10,517	9,913	1,666.34
11900 - Vendimet gjyqësore	1,455,620		
GJITHSEJ PAGAT DHE SHTESAT	9,154,515	11,799,577	4,108,209

13140 - Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendi	933		-
13141 - Para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	104	2,764	-
13142 - Akomodim për udhëtime zyrtare jashtë vendit	2,333	2,142	-
13143 - Shpenzimet tjera për udhëtimet zyrtare jashtë vendi	3,889		-
13310 - Interneti	6,889	6,384	4,560.00
13320 - Telefonia mobile	13,110	14,810	5,815.95
13330 - Shërbimet postare	5,007	5,611	174.50
13410 - Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	10,500	12,790	-
13430 - Shërbime e ndryshme shëndetsore		360	750.00
13440 - Shërbimet këshillëdhënëse dhe profesionale	12,417	10,082	-
13445 - Shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual	5,970	13,224	2,794.02
13450 - Shërbimet e shtypjes/printimit	45,198	70,181	12,225.30
13460 - Shërbimet kontraktuese të tjera	274,028	383,052	88,884.26
13470 - Shërbime teknike	20,994	24,889	3,214.96
13471 - Softuerët- Licencat dhe mirëmbajtja e tyre	4,800		480.00
13475 - Sigurimi fizik i objekteve publike	110,105	226,689	38,810.12
13480 - Shpenzimet e anëtarësimit	14,629	7,629	-
13501 - Mobilje më pak se 1000 euro	30,734	7,688	-
13503 - Kompjuterët me pak se 1000 euro	3,813	46,665	22,620.29
13504 - Hardwer për teknologji informative me pak se 1000 euro		235	-
13505 - Makinat fotokopieuse -multifunksionale	1,830		-
13509 - Pajisje tjera	6,364	74,631	1,970.00
13610 - Furnizimet për zyrë	56,379	93,407	56,346.94
13611 - Furnizime me dokumenta blanko (certifik. te lindje, kurorëzimi e	7,414	4,920	1,600.00
13615 - Furnizim me ushqim për kafshë		50	-
13620 - Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	71,666	89,915	25,070.72
13630 - Furnizime mjekësore	20,367	17,352	29,832.92
13640 - Furnizimet e pastrimit	28,171	27,741	15,458.87
13641 - Furnizim me veshmbathje(kodi 13650)		995	-
13710 - Vajëra	479		-
13720 - Nafta për ngrohje qendrore	25,349	65,715	22,157.80
13760 - Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	126,630	258,355	10,000.00
13780 - Derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	64,545	60,946	24,648.86
13820 - Avancë (Paradhënia)për udhëtime zyrtare	513		5,040.19
13950 - Regjistrimi i automjeteve	3,822	4,295	795.00
13951 - Sigurimi i automjeteve	9,997	13,057	1,196.90
13954 - Kontrollimi teknik i automjeteve	550	1,040	210.00
14010 - Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	23,122	32,962	16,024.21
14022 - Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	57,991	96,460	18,985.00
14023 - Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	212,955	152,566	129,094.96
14024 - Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	52,369	119,803	58,950.00
14026 - Mirëmbajtja e objekteve sportive		8,500	4,500.00
14032 - Mirëmbajtja e rrugëve lokale	176,883	310,305	86,608.68
14040 - Mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe te telekomunikimit		7,233	1,416.00
14050 - Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	86,721	164,910	47,055.00
14060 - Mirëmbajtja rutinore	108,331	129,542	23,122.00
14140 - Qiraja për makinëri ne shfrytëzim nga Instit. Publike			-
14310 - Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	22,743	32,098	11,171.80
14320 - Kompensimi i përfaqësimit jasht vendit		4,270	-
14410 - Vendimet gjyqësore	108,261	312,381	-
14450 - Pafesat-gjobat nderinstitucionale			1,000.00
MALLËRA DHE SHËRBIME	1,838,904	2,918,638	772,585

13210 - Energjia Elektrike	135,337	204,547	108,125.94
13220 - Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	27,083	28,789	13,447.24
13230 - Mbeturinat	36,476	36,947	16,679.72
13250 - Telefonia fikse	1,481	2,394	96.58
13260 - Pagesa - Vendime Gjyqësore	23,092	13,000	-
SHPENZIME TE KOMUNALIVE	223,469	285,677	138,349
21110 - Subvencionet për entitetet publike		30,000	-
21200 - Subvencionet për entitetet jopublike	429,252	587,336	112,087.00
22202 - Transferet për përfitues individual tjerë	372,746	416,815	10,400.00
22298 - Pagesat për shërbimet e varrimit	65,800	90,400	25,330.00
22299 - Qiraja për rastet sociale	5,610	10,200	3,060.00
22300 - Vendime Gjyqësore	38,235	20,713	-
SUBVENCIONE	911,643	1,155,464	150,877

Të dhënat në këtë tabelë bazohen në realizimin faktik për Tremujorin e Parë (Janar – Mars 2026) dhe paraqesin strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, duke reflektuar menaxhimin financiar dhe përdorimin e burimeve publike në përputhje me planifikimin buxhetor.

Paga dhe Shtesa, gjithsej shpenzime: 4,108,209 €

Kjo kategori përfshin pagat neto, tatimin në të ardhurat personale, kontributet pensionale të punonjësve dhe punëdhënësit, si dhe shtesat funksionale dhe përfitimet tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Struktura e shpenzimeve paraqet një shpërndarje të qëndrueshme ndërmjet komponentëve kryesorë të kompensimit, ku pesha kryesore mbetet në pagën bazë dhe kontributet përkatëse. Elementet shtesë, përfshirë kujdestarinë dhe punën jashtë orarit, reflektojnë organizimin e punës dhe kërkesat operacionale të institucionit.

Realizimi i kësaj kategorie është në përputhje me planifikimin buxhetor dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Mallra dhe Shërbime, gjithsej shpenzime: 772,585 €

Kjo kategori përfshin shpenzimet për furnizime me materiale, shërbime të jashtme, mirëmbajtje të objekteve, pajisje teknologjike dhe shërbime profesionale etj.

Struktura e saj reflekton mbështetjen e gjerë të proceseve operative dhe administrative, duke përfshirë përdorimin e shërbimeve të specializuara dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të aseteve institucionale.

Kjo kategori kontribuon drejtpërdrejt në funksionimin efikas të administratës dhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

Shpenzime Komunale, gjithsej shpenzime: 138,349 €

Kjo kategori përfshin shpenzimet për energji elektrike, shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, menaxhimin e mbeturinave dhe shërbimet e telekomunikimit.

Ajo përfaqëson një komponent esencial për funksionimin bazë të objekteve dhe shërbimeve publike, duke reflektuar konsum të rregullt dhe të domosdoshëm për operimin normal institucional.

Subvencione, gjithsej shpenzime: 150,877 €

Kjo kategori përfshin subvencionet për entitete publike, transfertat për përfitues individual dhe pagesat për raste sociale.

Struktura e saj reflekton angazhimin institucional në mbështetje të aktiviteteve publike dhe sociale, duke kontribuar në zhvillimin e komunitetit dhe realizimin e politikave sociale.

Shpenzimet për TM1 2026 janë realizuar në përputhje me planin dhe buxhetin e miratuar, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe standardet e menaxhimit financiar.

Struktura e përgjithshme e shpenzimeve paraqet një balancë ndërmjet kostove të personelit, shpenzimeve operative, shërbimeve bazë dhe mbështetjes sociale, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe efikas të institucionit.

Tabela 4 – Projektet Kapitale

643 SKENDERAJ		BUXHETI I PLANIFIKUAR	BUXHETI I SHPENZUAR	DIFERENCA	% E REALIZ.
10. BUXHETI NGA GRANTET QEVERITARE					
Kodi buxhetor	Emertimi i projekteve				
20827	Furnizimi dhe montimi i qilerave për objektin e komunes.	40,000.00	-	40,000.00	-
20691	Shenjzimi i shtigjeve për ecje ne zonen e Çyçavices	20,000.00	-	20,000.00	-
55819	Ndriçimi publik ne qytet dhe ne BL Kl. e Epërme, Prekaz,Qirez,Polac, Runikë dhe Bezallë	100,000.00	51,733.98	48,266.02	51.73
20824	Shenjzimi dhe ndertimi i shtigjeve të çiklizmit në qytet lagja 1,2 dhe rruga 17 shkurti	40,000.00	-	40,000.00	-
52556	Kanalizimi Aqarëve dhe Kopiliq i ulët	79,980.00	-	79,980.00	-
54005	Asfaltimi,riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në BL Likoc,Turiquevc,Runik,Qirez	200,000.00	-	200,000.00	-
43870	Fondi i bashkëfinancimit (DFEZH-ja)	260,000.00	-	260,000.00	-
52597	Blerja e pajisjeve motorike për pastrimin e qytetit	30,000.00	-	30,000.00	-
52602	Blerja e tabelave interaktive - digjitale në SHFMU Shaban Jashari, Ahmet Delia, Hamez Jashari dhe Anton Qetta	53,333.00	-	53,333.00	-
90313	Kanalizimi fekal ne fshatin Kline e Ulet	50,020.00	-	50,020.00	-
52572	Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez	100,002.00	-	100,002.00	-
52475	Punimi i rrjetit të ujësjellësit në Burojë	64,561.00	-	64,561.00	-
54304	Riparimi dhe zgjerimi i nënndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre	85,000.00	30,000.00	55,000.00	35.29
52618	Rregullimi i subqendrës -Likoc	100,000.00	-	100,000.00	-
52620	Rregullimi i subqendrës -Qirez	60,000.00	-	60,000.00	-
52615	Rregullimi i subqendrës -Runik	50,000.00	-	50,000.00	-
53903	Unaza e brendshme 3 krahu kah Llausha	158,376.00	-	158,376.00	-
55730	Riparimi dhe rregullimi i parkut "Idriz Rreci" dhe "Shaban Polluzha"	45,212.00	-	45,212.00	-
55733	Ndertimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet, Rr. "Ali Gashi", "28 Nentori", "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci"	90,000.00	-	90,000.00	-
55772	Ndërtimi i muzeut dhe bibliotekes se qytetit	100,000.00	-	100,000.00	-
20799	Asfaltimi i rrugëve lokale ne BL Likofc, Turiquevc, Runikë, Polac, Klinë, Prekaz, Qirez	10,000.00	-	10,000.00	-
20800	Rrethrotullimi në hyrje te kKompleksit në Prekaz dhe nënkalimi në sheshin Adem Jashari	10,000.00	-	10,000.00	-
20998	Paisje per Lavanteri	15,000.00	-	15,000.00	-
		1,761,484.00	81,733.98	1,679,750.02	

Kodi buxhetor	21 BUXHETI NGA TE HYRAT VETANAKE	BUXHETI I PLANIFIKUAR	BUXHETI I SHPENZUAR	DIFERENÇA	% E REALIZ.
55819	Ndriçimi publik ne qytet dhe nb BL Kl. e Epërme, Prekaz,Qirez,Polac, Runikë dhe Rezallë	150,000.00	-	150,000.00	-
20824	Shenjëzimi dhe ndertimi I shtigjeve të çiklizmit në qytet lagja 1,2 dhe rruga 17 shkurti	30,000.00	-	30,000.00	-
50056	Kanalizimi fekal Syrigane - Baje	20,000.00	-	20,000.00	-
54005	Asfaltimi,riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në BL Likoc,Turiquevc,Runik,Qirez	68,358.00	-	68,358.00	-
52556	Kanalizimi Aqarevë dhe Kopiliq i ulët	130,020.00	-	130,020.00	-
52572	Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez	50,000.00	-	50,000.00	-
52618	Rregullimi i subqendrës -Likovc	185,853.00	-	185,853.00	-
52620	Rregullimi i subqendrës -Qirez	51,947.00	-	51,947.00	-
52615	Rregullimi i subqendrës -Runik	57,000.00	-	57,000.00	-
52621	Rregullimi i subqendrës - Klinë e Eperme	50,000.00	-	50,000.00	-
52631	Ndërtimi I objektit te kompleksi I UÇK - së Objekti I Ç-së	100,000.00	-	100,000.00	-
51211	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik në BL Likovc,Klinë e Epërme,Klinë e mesme, Polac,Runik,Turiquevc, Prekaz, Qirez, Runik	10,000.00	-	10,000.00	-
52646	Tribunat ne stadiumin e qytetit	50,000.00	-	50,000.00	-
55730	Riparimi dhe rregullimi I parkut "Idriz Rreci" dhe "Shaban Polluzha"	54,788.00	-	54,788.00	-
55733	Ndertimi dhe asfaltimi I rrugëve në qytet, Rr. "Ali Gashi", "28 Nentori", "Fehmi dhe Xhevë Lladrovc"	130,500.00	-	130,500.00	-
55772	Ndërtimi I muzeut dhe bibliotekes se qytetit	50,000.00	-	50,000.00	-
55780	Rregullimi I kulmit te objekteve - banesat e kuqe	50,000.00	-	50,000.00	-
55785	Ndertimi I kolektorit Llaushë - Tushilë - Aqarevë faza I	50,000.00	-	50,000.00	-
20799	Asfaltimi I rrugëve lokale ne BL Likofc, Turiquevc, Runikë, Polac, Klinë, Prekaz, Qirez	30,000.00	-	30,000.00	-
20800	Rrethrotullimi në hyrje te Kompleksit në Prekaz dhe nënkalmi në sheshin Adem Jashari	30,000.00	-	30,000.00	-
		1,348,466.00	-	1,348,466.00	

Tabela Nr.5. Shpenzimet sipas programeve

LLOJI I SHPENZIMEVE	PROGRAMET SHPENZIMESH TE BUSHETIT 2025															Totali
	Zyra e Kryetarit	Administrata	Inspektioni	Prokurimi	Zë e KK	Busheti	SHP	ZLK	Bujqësia	Fl.dhe.zhv .ek.	GJK dhe p	Urbanizimi	Shëndetesi	K.R dhe S	Arsimi	
11111 - Paga neto	43,449	68,071	21,204	8,269	52,989	39,527	65,225	13,158	19,836	15,009	25,589	24,894	438,120	35,488	1,585,317	2,456,145
11121 - Talimi në të ardhurat personale	4,760	6,594	2,210	925	4,357	3,863	6,266	1,278	1,823	1,592	2,414	2,637	48,656	3,301	162,322	252,997
11131 - Kontributi pensional - punëtori	3,281	5,256	1,621	670	3,656	3,071	5,293	1,039	1,527	1,218	1,942	1,907	36,232	2,732	125,896	195,341
11151 - Sindaketat		112				134	18		31	12	61		1,313	65	6,800	8,551
11152 - Odat profesionale													5,412			5,412
11211 - Penoja e punës	2,149	3,984	821	516	1,698	2,295	5,238	1,071	952	878	1,182	1,292	28,523	2,117	122,105	174,820
11311 - Kontributi pensional - punëdhënësi	3,281	5,256	1,621	670	3,656	3,071	5,293	1,039	1,527	1,218	1,942	1,907	36,232	2,732	125,896	195,341
11411 - Shëtitja e vegjër për të rriturit																
11413 - Shëtitja e performancës	13,830	21,107	6,561	2,717	13,248	12,523	20,777	4,230	6,115	5,618	7,484	7,402	140,143	10,937	509,920	782,642
11421 - Shëtitja funksionale për arsimin universitar																
11431 - Kujdesimi, puna gjatë natës & puna jashtë orarit të punës				302			3,046		261		173		25,958		5,556	35,295
11611 - Shëtitja tranzitore	1,389												277			1,666
PAGAT DHE SHITESAT	72,138	110,381	34,038	14,069	79,604	64,483	111,156	21,820	32,072	25,574	40,788	40,038	760,864	57,372	2,643,812	4,108,209
13141 - Para shërbimeve për udhëtime zyrtare jashtë vendit																
13142 - Akomodimi për udhëtime zyrtare jashtë vendit																
13310 - Interneti															4,560	4,560
13320 - Telefonia mobile							4,562						260		994	5,816
13330 - Shërbimet postare		175														175
13410 - Shërbimet e arsimit dhe trajnimit																
13430 - Shërbime e ndryshme shëndetësore													750			750
13440 - Shërbimet keshillëdhënëse dhe profesionale																
13445 - Shërbimet e vëprata - kontraktet dhe kontraktet individual												2,794				2,794
13450 - Shërbimet e shërbimit prindit		3,800				1,473	2,000						414	2,200	2,339	12,225
13460 - Shërbimet kontraktuese të tjera	600	1,000		1,400		43		2,600					66,984		16,258	88,884
13470 - Shërbime teknike													499	2,716		3,215
13471 - Softueret-licencat dhe mirëmbajtja e tyre		480														480
13480 - Shpenzimet e anëtarësisë																
13475 - Sigurimi fizik i objekteve publike							38,810									38,810
13501 - Mobijet																
13503 - Komputeret															22,620	22,620
13504 - Pajisjet e teknologjive informative dhe të komunikimit																
13509 - Pajisje tjera							1,970									1,970
13610 - Furnizimet për avio	2,105			787						1,370			2,790	313	48,983	56,347
13611 - Furnizimet e dokumenteve bibliotekës													1,600			1,600
13615 - Furnizimet me ushqim për kafite																
13620 - Furnizimi me ushqim dhe pije (jo drektë zyrtare)	3,090	600			446	40	352	100		600	448	180	9,613		9,603	25,071
13630 - Furnizimi mjekësor													29,833			29,833
13640 - Furnizimet e pastimit													4,109	220	11,130	15,459
13650 - Furnizimi me veshmbathje																
13720 - Nalla për ngrohje qendrore													13,519		8,639	22,158
13760 - Drita dhe përdorimet e drurit për nallat															10,000	10,000
13780 - Derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	2,166	294	1,393		43	64	7,784	176	282		49	180	7,284	543	4,391	24,649
13820 - Avancë (Pardhënia) për udhëtime zyrtare		4,502				539										5,040
13950 - Regjistrimi i automjeteve		75					330						360		30	795
13951 - Sigurimi i automjeteve		314			157								726			1,197
13954 - Kontrollimi teknik i automjeteve		30			30		150									210
14010 - Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve		1,796	170		2,400		5,992						5,666			16,024
14022 - Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe aëriete							18,985									18,985
14023 - Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore		1,900				3,370			4,000	2,000	39,000				78,825	129,095
14024 - Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore													58,950			58,950
14026 - Mirëmbajtja e objekteve sportive									1,500					3,000		4,500
14032 - Mirëmbajtja e rrugëve lokale			46,609				40,000									86,609
14040 - Mirëmbajtja e teknologjive informative dhe të telekomunikimit		1,416														1,416
14050 - Mirëmbajtja e mobijëve dhe pajisjeve		13,875					140						150		32,890	47,035
14060 - Mirëmbajtja rutinore							23,122									23,122
14310 - Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit					1,345	60										1,405
14320 - Kompensimi i përfaqësimit jashtë vendit															9,767	11,172
14410 - Vendimet gjyqësore																
14450 - Pagesat-igjobat rëderistucionale													1,000			1,000
MALLËRA DHE SHËRBIMET	7,961	30,256	48,172	2,187	4,420	5,588	144,196	2,876	5,782	600	3,867	42,154	204,507	8,992	261,028	772,585
13210 - Energia Elektrike							47,826						21,706		38,594	108,126
13220 - Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit							1,537						3,072		8,839	13,417
13230 - Mbeturinat							1,069						1,600		14,011	16,680
13250 - Telefonia fise													97			97
13260 - Pagesat - Vendime Gjyqësore																
SHËRBIMET E KOMUNALIVE							50,432						26,474		61,444	138,349
21110 - Subvencionet për entitetet publike																
21200 - Subvencionet për entitetet jo publike									46,667	13,050			51,900	470		112,087
22202 - Transferet për përfitues individual tjerë	9,000													1,400		10,400
22298 - Pagesat për shërbimet e varamit							25,330									25,330
22299 - Orija për rastet sociale													3,060			3,060
22300 - Vendime Gjyqësore																
SUBVENCIÓNË DHE TRANSFERË	9,000						25,330		46,667	13,050			54,960	1,870		150,877

Në përfundim, realizimi i buxhetit për TM1 2026 karakterizohet nga një qasje e kujdesshme dhe e kontrolluar në menaxhimin e financave publike.

Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti financiar është zhvilluar në kushte të kufizimeve ligjore për shkak të vonesës në miratimin e Ligjit të Buxhetit për vitin 2026, duke ndikuar në ritmin e ekzekutimit veçanërisht të investimeve kapitale. Si rezultat, fokusi kryesor ka qenë në mbulimin e shpenzimeve esenciale dhe sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit institucional.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, struktura e shpenzimeve tregon disiplinë financiare dhe përputhje me prioritetet buxhetore, duke garantuar stabilitet operacional dhe ofrim të pandërprerë të shërbimeve publike.

Me krijimin e bazës së plotë ligjore për ekzekutimin e buxhetit, pritet që në periudhat në vijim të ketë intensifikim të realizimit të projekteve dhe përmirësim të mëtejshëm të performancës financiare.


Drejtori i DBF-së
Z. Behxhet Maliqi



Kryetari i Komunës
Z. Sami Lushtaku



Republika e Kosovës
Republic Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Kryetari i Komunës së Skenderajt, me rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-177/14, të datës 03.04.2026, për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020/01-0008203/26, i miratuar më datë 27.02.2026, duke u bazuar në nenin 53, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 58, shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, ndërlikur me nenin 50, paragrafi 1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.110-385 të datës: 03.12.2008, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane dhe në përputhje me Rregulloren Nr.01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës së Skenderajt, i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e rregullt të datës _____.2026, të miratojë këtë:

PROPOZIM

- I. Propozohet rishqyrtimi i Vendimit Nr. 01-020/01-0008203/26, të datës 27.02.2026, për themelimin e Komisionit të Kuvendit të Komunës për Zgjedhjen e Këshillave Lokale.
- II. Në nenin I të Vendimit bazë, tek përbërja e Komisionit të respektohet parimi i barazisë gjinore, në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, për të siguruar kështu përfaqësim të barabartë gjinor në përbërjen e Komisionit të Kuvendit të Komunës për Zgjedhjen e Këshillave Lokale, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Rregulloren Nr.01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës së Skenderajt dhe rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-177/14, të datës 03.04.2026.
- III. Me hyrjen në fuqi të vendimit të Kuvendit, të plotësohet / ndryshohet vendimi bazë Nr.01-020/01-0008203/26, i datës 27.02.2026.
- IV. Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës

Sami Lushtaku



ORJESHE - IZLAZNA - OUTGOING
 REPUBLIKA KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Nr. 020 - 177 / 14
 -01- Data: 03.04.2026
 Datum: 03.04.2026
 Date:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu-Alija, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 25.03.2026 VI-020-177
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
 E nderuar Kryesuese,
 Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr.01-020/01-0008203/26 për themelimin e komisionit të kuvendit të komunës për zgjedhjet e këshillave lokale
I miratuar më datë: 27.02.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.03.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026, ka miratuar vendimin Nr.01-020/01-0008203/26 për themelimin e komisionit të kuvendit të komunës për zgjedhjet e këshillave lokale.

MAPL konstaton se vendimin Nr.01-020/01-0008203/26 për themelimin e komisionit të kuvendit të komunës për zgjedhjet e këshillave lokale, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, si dhe me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2019 (MAPL), për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane ku përcaktohet se :

Në nenin 6, paragrafët 7 dhe 8, të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, parashihet se: "Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.

Ndërsa në nenin 5, paragrafi 3, të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2019 (MAPL), për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane ku përcaktohet se :


Komisioni do të reflektoj përfaqësimin gjinor dhe etnik.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Skenderajt duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe neni 40 par. 1 dhe 2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vendbanime dhe Lagjet Urbane, dhe Rregullorja Nr.01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Funksonimin dhe bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vendbanime dhe Lagjet Urbane të Komunës së Skenderajt, dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 27.02.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

(Për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale)

Neni 1

Miratohet propozimi-vendim më Nr.02-020/01-0006898/26, i datës; 20.02.2026, Për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij vendimi komisionit ka këtë përbërje si në vijim:

1. **z. Fadil Nura** - anëtarë nga ekzekutivi,
2. **z. Alban Berisha** - anëtarë nga legjislativi,
3. **z. Nezir Bejta** - anëtarë nga legjislativi,
4. **z. Afrim Kabashi** - anëtarë nga legjislativi,
5. **z. Hisni Avdullahi** - anëtarë nga legjislativi,
6. **z. Milazim Mustafa** - anëtarë nga shoqëria civile,
7. _____ anëtar nga lokaliteti (fshatë, vendbanim apo lagje).

Neni 3

Detyrat e komisionit është që të bëjë koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale dhe për punën e tij i raporton Kuvendit Komunal.

Neni 4

Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e kuvendit të komunës.

Neni 5

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Anëtarët e Komisionit, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb - faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit .
- 1x1 Anëtarëve të komisionit,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIK E KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / SKUPSTINA OPSTINE / SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-357/01-0014193/26
Data
Data 29.04.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës / Skupstina Opstine / Municipal Assambly

Kryetari i Komunës së Skenderajt, pas pranimit të Rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr. 1128-2/26, dt.19.03.2026, në bazë të nenit 12, nenit 13, 17 dhe 58 shkronja a) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040, nenit 50 shkronja a) dhe shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01/110-385, të datës 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 5, paragrafi 1.2., nënparagrafi 1.2.1, nenin 10, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 dhe nenin 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, si dhe Udhëzimin Administrativ MMPH Nr.11/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal në mbledhjen e rregullt të datës 30.04.2026, i propozon për miratim Kuvendit të Komunës këtë:

PROPOZIM

- Rishqyrtimin e Vendimit Nr.01-361/01-0008195/26, për miratimin e vendimit për iniciimin e procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034, të miratuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Skenderajt të datës 27.02.2026 dhe të formulohet si në vijim:

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim lillohet hartimi i Planit Zhvillimor Komunal i Skenderajt .

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si Plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Planin Zhvillimor Komunal nga neni 1, i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Skenderajt, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Plani strategjik multi-sektorial, i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

Neni 4
Kufiri i territorit

Zonat Kadastrale në territorin e Komunës së Skenderajt janë:

Nr.	Zona Kadastrale	Sipërfaqet		
		ha	a	m2
1	Baks	537	44	94
2	Bajë	1033	20	12
3	Burojë	1191	99	37
4	Vitak	580	77	3
5	Vajnikë	1257	56	47
6	Klinë e Epërme	885	45	31
7	Kopiliq i Epërm	419	78	3
8	Prekaz i Eperm	1177	6	83
9	Klinë e Poshtme	485	39	21
10	Abri e Ulët	1074	23	41
11	Dashec	177	43	82
12	Kopiliq i Ulët	942	52	30
13	Prekaz i Ulët	580	97	84
14	Izbicë	687	44	10
15	Klladernicë	1176	57	19
16	Kozhicë	445	75	21
17	Kotorr	899	66	15
18	Kosterc	572	76	92
19	Kralic	733	60	45
20	Krasaliq	317	67	89
21	Krasmiroc	388	59	17
22	Kryshec	326	37	0
23	Kuqicë	1156	90	57
24	Llaushë	2196	29	19
25	Likoc	714	46	52
26	Leçinë	784	18	58
27	Lubavec	638	24	25
28	Makërmal	558	93	56
29	Marinë	325	6	48
30	Mikushnicë	726	85	19
31	Murgë	328	54	97
32	Polac i Ri	767	29	41

33	Fshat i Ri (Novosellë)	203	24	45
34	Aqarevë	1252	71	2
35	Pemishtë	223	64	84
36	Plluzhinë	536	87	8
37	Prelloc	299	76	58
38	Rakinicë	652	14	8
39	Radishevë	1263	35	38
40	Rezallë	1407	98	74
41	Runik	1135	8	97
42	Skenderaj	465	77	41
43	Klinë e Mesme	407	35	32
44	Polac i Vjetër	694	5	52
45	Syriganë	677	60	92
46	Ticë	414	53	42
47	Ternac	620	0	80
48	Turiqec	663	17	66
49	Tushilë	280	4	96
50	Çirez	681	66	22
51	Çitak	266	10	1
52	Çubrel	1105	62	39
	<i>Totali</i>	<i>37314</i>	<i>2560</i>	<i>2325</i>

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria për Urbanizëm, dhe Mbrojtje të Ambientit, ndërsa sipas nevojës mund të kontraktohet edhe ndonjë kompani profesionale e licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Skenderajt Drejtoria për Urbanizëm, dhe Mbrojtje të Ambientit, koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1. të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor të hartojë në afat brenda 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultime Publike

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal para finalizimit duhet të vihet në konsultim publik dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9
Afati i Vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën kohore së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 10
Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jete në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11
Programi

Pjese e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11. pika 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.

Neni 12
Hyrja ne fuqi

Me miratimin nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, ky Vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr-03-L- 040 për Vetëqeverisjen Lokale. dhe publikimi në web-faqen Zyrtare të Komunës.

II. Ky propozim-vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bashkëngjitur:

- Programi për Hartimin dhe Menaxhimin e Procesit të Planifikimit 2026-2032. (pjesë e vendimit).

I dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës
Samir Lushtaku



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	<u>02</u>
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	<u>1128-2/26</u>
Nr. I faqera Broj. stranica No. pages	<u>1</u>
Data Datum Date	<u>19.03.2026</u>
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Sami Lushajqi, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu-Alija, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Çeliku, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nr. a:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH Nr. 11.26/26 Datë: 12.03.2026
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari i konfirmues vlerësimit ligjor	Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e
2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	Ferfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 01-361/01-0008195/26 për miratimin e inicimit të procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034, miratuar nga Kuvendi I Komunës së Skenderajt

I nderuar kryetar Lushaku,
E nderuar kryesuese Spahiu-Alija

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 10.03.2026 ka praruar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin Nr. 01-361/01-0008195/26 për miratimin e inicimit të procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034, miratuar nga Kuvendi I Komunës së Skenderajt

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Skenderajt:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimi Nr. 01-361/01-0008195/26 për miratimin e inicimit të procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034

ARSYETIMI

MMPH pas shqyrtimit të Vendimit të lartcekur konstatoi se:

Vendimi nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Vendimi në fjalë duhet të plotësohet në preambule dhe në përmbajtje.


Vendimit duhet të i bashkëngjitet programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, sipas nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. të ligjit.

Të bashkëngjitet gjeri Vendimin e Komunës së Prizrenit, i cili mund të shërbej si orientues në hartim të këtij propozimi vendimit dhe programit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assambly

Në bazë të nenit 11, dhe 12 nenparagrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 shkronja b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 5 paragrafi 1.2 nen paragrafi 1.2.1 neni 6 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, neni 11, paragrafi 1.2, neni 10 paragrafi 2 nen paragrafi 2.1, neni 15 dhe 26 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, ndërlidhur me nenin 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 i dt.03.12.2008, dhe në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, Kuvendi i Komunës ne mbledhjen e rregullt te mbajtur me datën; 27.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

(Për miratimin e inicimit të procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034)

- I. Miratohet Propozim - Vendimi me Nr. 06-351/01-0007023/26, i datës; 20.02.2026, për inicimin e procedurës së hartimit të **Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034**
- II. Plani Zhvillimor Komunal do të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.
- III. Miratimi i inicimit të procedurës së hartimit të PZHK-së së cekur në pikën një të këtij vendimi , vjen pasi që Plani Zhvillimor Komunal (2017-2025) ka kaluar periudhën tetë (8) vjeçare nga data 31.12.2025.
- IV. Plani Zhvillimor Komunal 2026-2034 do të hartohet nga një kompani profesionale e kontraktuar nga DUMA, në bashkëpunim edhe me ekspertë e fushës, dhe pas kalimit të procedurave të diskutimit publik, do të propozohet për miratim në Kuvendin Komunal.
- V. Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen të Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

1x1 DUMA,
1x1 MAPL-së,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 Arkivit,
1x1 Dosjes.

KRYESUESJA E KUVENDIT

znj. Adelina Spahiu-Adiça



**Programi i punës
për hartimin dhe menaxhimin e Planit Zhvillimor Komunal**

Bazuar në kërkesat ligjore bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, (PZHK), është autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinore.

Aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal;

1. Punët parapërgatitore

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përcaktimi i grupit punues	A. Përcaktimi i udhëheqësit të projektit, koordinatorëve të drejtorive (KD) vijuese: a. Administratë e Përgjithshme, b. Bujqësi c. Buxhet dhe financa d. Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport e. Shërbime Publike , Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim f. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale g. Zhvillim ekonomik i. Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis	Përcaktimi i grupit punues	1 javë	Kryetari i Komunës
2. Përcaktimi i grupeve të interesit	A. Përcaktimi i grupeve lokale të interesit, institucione të qeverisë qendrore, organizata të jashtme që ofrojnë shërbime publike, OJQ, biznese, përfaqësues të fshatrave dhe bashkësive lokale (GP); B. Krijimi i listës dhe kontakteve të pjesëmarrësve.	Në mënyrë që PZHK të përkrahet nga banorët e komunës, nevojitet që të përcaktohet organizatat dhe përfaqësuesit e komuniteteve.	1 javë	Udhëheqësi i projektit

3. Trajnimi punonjësve të Komunës	<p>A. Njoftimi i drejtorive rreth procesit të planifikimit hapësinor dhe PZHK-ës nga autoritet përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinore.</p> <p>B. Trajnimi i punonjësve nga kompania konsulentë për shfrytëzim të GIS-it dhe aplikacioneve tjera;</p>	Përgatitja e dokumentit të harmonizuar dhe të qëndrueshëm, drejtorit sektoriale duhet te njoftohen rreth implikimeve ligjore dhe të dhënave qe nevojiten.	1 Javë	Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinore.
4. Hartimi i konceptit dhe planit të punës	<p>A. Shqyrtimi i Kornizës Logjike të PZHK-ës sipas UA dhe ligjit;</p> <p>B. Identifikimi i Rreziqeve/Kërcënimeve;</p> <p>C. Vlerësimi i PZHK-ës paraprake;</p> <p>D. Analizimi i Planit Hapësinor të Kosovës, që përcakton zhvillimet për Komunë.</p> <p>E. Krijimi i strukturës përmbajtjesore të PZHK-ës;</p> <p>F. Prezantimi i strukturës dhe konceptit të punës, para drejtorive Komunale.</p>	Në mënyrë që të zhvillohet një koordinim i qëndrueshëm i drejtorive sektoriale, nevojitet që të miratohet një strukturë e dokumentit mbi të cilin do të bazohet një plan i hollësishëm i punës përgjatë hartimit të PZHK-ës.	3 javë	Udhëheqës i komunal i projektit
5. Zhvillimi i takimeve njoftuese me banorët	<p>A. Përgatitja e prezantimit të planit të punës dhe qëllimit të PZHK-ës për takimin njoftues me banorët dhe GP;</p> <p>B. Takimi njoftues me banorë të zonës urbane dhe GP;</p> <p>C. Katër takime njoftuese me banorë të zonës urbane.</p>	Në mënyrë që banorët dhe GP të jenë të njoftuar rreth metodologjisë së kontributit të tyre, nevojitet një takim njoftues.	2 javë	Udhëheqës i komunal i projektit

2. Grumbullimi i dhe vlerësimi i të dhënave nga Drejtorit Komunale

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Grumbullimi i të dhënave komunale	<p>A. Grumbullimi i të dhënave të drejtorive vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga drejtorit përkatëse; b. Administratë e Përgjithshme c. Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik d. Kulturë, Rini dhe Sport e. Trashëgimi kulturore f. Shërbime Publike dhe Emergjencë g. Inspektim komunal h. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i. Arsim j. Buxhet dhe Financa k. Planifikim hapësinor l. Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë. 	Në mënyrë që të përgatitet Profili i PZHK-ës nevojitet që grumbullohen të dhënat dhe e kërkuara sipas UA për PZHK..	3 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
2. Grumbullimi i të dhënave të nivelit qendror dhe	<ul style="list-style-type: none"> A. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga ministritë përkatëse; B. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të 	Në mënyrë që të përgatitet Profili i PZHK-ës nevojitet që grumbullohen të dhënat dhe e kërkuara	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

kompaniv e regionale	dhënave të nevojshme nga ujësjellësi regional,	sipas UA për PZHK.		
3. Grumbulli mi të dhënave të operatorëve tjerë publik dhe organizata Ndërkombë tar- are	A. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga furnizuesit me rrymë elektrike; B. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga operatorët e telekomunikacionit;	Në mënyrë që të përgatitet Profili i PZHK-ës nevojitet që grumbullohen të dhënat dhe e kërkuara sipas UA për PZHK.	2 javë	Udhëheqës i komunal i projektit
4. Vlerësimi i të dhënave nga konsulentët	A. Vlerësimi i të dhënave të grumbulluara nga konsulentët dhe formatizimi i tyre sipas UA për PZHK.	Në mënyrë që të dhënat të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, nevojitet një vlerësim i plotësimi të këtyre kërkesave.	3 javë	Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhi m hapësinor
5. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë që ligjërisht kërkohen	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për PZHK.	1 javë	Udhëheqës i komunal i projektit

3. Përgatitja e Profilit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
---------	-------------	---------	-------------	------------

<p>1. Përpilimi i përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografik e të Profilit Komunal</p>	<p>A. Plotësimi i Profilit me të dhënat e grumbulluara, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Historiku i zhvillimit të Komunës b. Pozita c. Gjendja ekzistuese demografike d. Gjendja ekzistuese e veçorive mjedisore e. Gjendja ekzistuese e zhvillimit ekonomik f. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës teknike g. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së transportit dhe transportit publik h. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës publike i. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës sociale j. Gjendja ekzistuese e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri k. Gjendja ekzistuese e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe 	<p>Në mënyrë që të përgatitet Vlerësimi i Gjendjes Ekzistuese është i domosdoshëm të përgatitet pasqyra e gjendjes ekzistuese.</p>	<p>4 javë</p>	<p>Udhëheqës i komunal i projektit</p>
--	--	--	---------------	--

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
	turistike l. Gjendja ekzistuese e vendbanimeve m. Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës.			
2. Konsultimi i Profilit Komunal nga Grupet Punuese	A. Vlerësimi i Profilit nga KD B. Vlerësimi i Profilit nga GP C. Inkorporomi i komenteve dhe sugjerimeve	Në mënyrë që të kompletohet Profili i PZHK-ës nevojitet që grumbullohen të dhënat dhe e kërkuara sipas UA për PZHK.	2 javë	KD, GP
3. Shqyrtim i publik i Profilit	A. Përgatitja e prezantimit të Profilit për Shqyrtimin publik; B. Zhvillimi i shqyrtimin publik të Profilit.	Në mënyrë që të plotësohet Profili me të dhënat e fundit, është i nevojshëm prezantimi publik i tij.	2 javë	Udhëheqës i komunal i projektit
4. Plotësim dhe përfundimi i Profilit	A. Inkorporomi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët		1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

4. Përgatitja e Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
---------	-------------	---------	-------------	------------

<p>1. Përpilimi i përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografik e të Profilit Komunal</p>	<p>A. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese në raport synimet e qeverisë qendrore dhe standardeve hapësinore, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Gjendja ekzistuese e zhvillimit ekonomik b. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës teknike c. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së transportit dhe transportit publik d. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës publike e. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës sociale f. Gjendja ekzistuese e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri g. Gjendja ekzistuese e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike h. Gjendja ekzistuese e vendbanimeve i. Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës 	<p>Përpilimi i përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografike të Profilit Komunal</p>	<p>4 javë</p>	<p>Udhëheqës i komunal i projektit</p>
--	---	--	---------------	--

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
2. Konsultimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese nga Grupet Punuese	<ul style="list-style-type: none"> A. Shqyrtimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese nga KD B. Shqyrtimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese Profilit nga GP C. Shqyrtimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese. D. Inkorporomi i komenteve dhe sugjerimeve 	Konsultimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese nga Grupet Punuese	2 javë	KD, GP
3. Shqyrtimi publik i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese	<ul style="list-style-type: none"> A. Përgatitja e shqyrtimit publik të Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese për prezantim publik; B. Zhvillimi i shqyrtimit publik të Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese. 	Prezantimi publik i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese	2 javë	Udhëheqës i komunal i projektit
4. Plotësimi dhe përfundimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese	<ul style="list-style-type: none"> A. Inkorporomi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët 	Plotësimi dhe përfundimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese	1 javë	Udhëheqës i komunal i projektit

5. Përgatitja e SWOT analizës, Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Zhvillimi punëtorisë për caktimin e SWOT analizës, Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> A. Përcaktimi i agjendës dhe pjesëmarrësve në punëtori B. Përcaktimi i SWOT analizës të gjendjes ekzistuese për: <ul style="list-style-type: none"> a. Gjendjen ekzistuese e zhvillimit ekonomik, b. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës teknike, c. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës së transportit dhe transportit publik, d. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës publike, e. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës sociale f. Gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri 	Në mënyrë që planifikimi të jetë i harmonizuar dhe i qëndrueshëm, nevojitet që të zhvillohet një punëtori me KD, punonjës të drejtorive të ndryshme komunale dhe pjesëtarë tjerë të GP.	1 javë	Udhëheqës i komunal i projektit

- | | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none">g. Gjendjen ekzistuese të aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistikeh. Gjendjen ekzistuese të vendbanimevei. Gjendjen ekzistuese të shfrytëzimit të tokës. <p>C. Përcaktimi i Vizionit dhe Qëllimeve</p> | | | |
|--|---|--|--|--|

	<p>D. Përcaktimi i Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për zhvillimin:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ekonomik Infrastrukturës teknike Infrastrukturës së transportit dhe transportit publik Infrastrukturës publike Infrastrukturës sociale Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri Aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike Vendbanimeve Shfrytëzimit të tokës. 			
2. Përgatitja e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor	<ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor dhe skenarëve të mundshëm; Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga KD Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor Profilit nga GP Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga konsulentët Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve 	Në mënyrë që të kompletohet Profili i PZHK-ës nevojitet që të grumbullohen të dhënat e kërkuara sipas UA për PZHK.	4 javë	KD, GP
3. Shqyrtimi publik i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor	<ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e shqyrtimit publik të Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor për prezantim publik; Zhvillimi i diskutimit publik të Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor. 	Në mënyrë që të kompletohet PZHK, të përkrahet dhe zbatohet nevojitet prezantimi i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
4. Plotësimi dhe përfundimi i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së	A. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët		1 javë	Udhëheqës i komunal i projektit

Zhvillimit Hapësinor				
-------------------------	--	--	--	--

6. Përgatitja e Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim	<p>A. Përcaktimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim për arritje e qëllimeve dhe objektivave në fushën:</p> <p>a. Ekonomike</p> <p>b. Infrastrukturës teknike</p> <p>c. Infrastrukturës së transportit dhe transportit publik</p> <p>d. Infrastrukturës publike</p> <p>e. Infrastrukturës sociale</p> <p>f. Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri</p> <p>g. Aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike</p> <p>h. Vendbanimeve</p> <p>i. Shfrytëzimit të tokës.</p>	Në mënyrë që planifikimi të jetë i harmonizuar dhe i qëndrueshëm, nevojitet që të zhvillohet një punëtori me KD, punonjës të drejtorive të ndryshme komunale dhe pjesëtarë tjerë të GP.	4 javë	Udhëheqës i komunal i projektit
2. Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim	<p>A. Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim nga KD</p> <p>B. Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim nga GP</p> <p>C. Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim nga konsulentët</p> <p>D. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve</p>	Në mënyrë që të përcaktohen veprimet sipas planeve sektoriale dhe kornizës kohore nevojitet shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim.	1 javë	KD, GP
3. Plotësimi dhe përfundimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim	A. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët		1 javë	Udhëheqës i komunal i projektit

7. Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes së PHZV-ës

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes së PZHK-ës	A. Përfundimi i Kapitullit të Sfondit B. Konsolidimi tërë dokumentit	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-ës.	4 javë	Udhëheqës i komunal i projektit
2. Dorëzimi i PZHK-ës në MMPH për vlerësimin e përmbajtjes para zhvillimit të Shqyrtimit Publik	A. Dorëzimi i draftit përfundimtar të PZHK-ës në MMPH; B. Përgatitja e prezantimit të draftit përfundimtar të PZHK-ës në MMPH; C. Prezantimi i draftit përfundimtar të PZHK-ës në MMPH. D. Miratimi i MMPH-s për iniciimin e shqyrtimit publik të draftit përfundimtar të PZHK-ës në MMPH	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-ës.	2 javë	Udhëheqës i komunal i projektit

8. Shqyrtimi publik i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-ës)

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Vendimi për zhvillimin e Shqyrtimit Publik	A. Përgatitja e vendimit për shqyrtimin publik të PZHK-ës; B. Njoftimi i banorëve dhe akterëve tjerë për zhvillimin e shqyrtimit publik;	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-ës.	1 javë	Kryetari i Komunës
2. Zhvillimi i Shqyrtimit Publik	A. Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi publik i draftit përfundimtar të PZHK-ës; B. Mbajtja e ekspozitës të përmbajtjes së draftit përfundimtar të PZHK-ës; C. Pranimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve nga banorëve dhe akterëve tjerë.	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-ës.	4 javë	Udhëheqës i komunal i projektit
3. Raporti i Shqyrtimit Publik	A. Përgatitja e Raportit të Shqyrtimit Publik	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-ës.	2 javë	Udhëheqës i komunal i projektit
4. Inkorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve	A. Ndryshimi i PZHK-ës në përputhje me vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e arsyeshme të dorëzuara,	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-ës.	2 javë	Udhëheqës i komunal i projektit

9. Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-ës)

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Miratimi i PZHK-ës nga MMPH	<p>A. Dorëzimi i PZHK-ës në MMPH për miratim</p> <p>B. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga MMPH, në rast se ka</p> <p>C. Miratimi i PZHK- së nga MMPH</p>	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-së.	4 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
2. Miratimi i PZHK-ës nga Kuvendi Komuna l	<p>A. Dorëzimi i PZHK-ës në Kuvend Komunal për miratim</p> <p>B. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga Kuvendi Komunal, në rast se ka;</p> <p>C. Miratimi i PZHK-ës nga Kuvendi Komunal</p>	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-së.	2 javë	Kryetari i Komunës

PROGRAMI NË BAZË AKTEVE LIGJORE PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL PËR PERIUDHEN 2023-2031 PËR KOMUNËN E SKENDERAJ.

INFORMATA TË PËRGJITHSHME

1.Komuna e Skenderaj

POZITA GJEOGRAFIKE

Në një sipërfaqe prej 378 km², e shtrirë në qendër të Drenicës, Komuna e Skënderajit kufizohet në veri me Komunën e Mitrovicës dhe Zubin Potokun, në lindje me Vushtrrinë, në juglindje me Drenasin (Gllogovcin), në jug me Malishevën, në jugperëndim me Klinën, ndërsa në perëndim me Burimin (Istogun). Kjo sipërfaqe prej 37, 439, 83 ha, ka mbi 40% tokë të punueshme.

Territori i Komunës së Skënderajit ka një konfiuracion kodrinoro-malor me lartësi mbidetare mesatare prej 500-700m, kurse pikën më të lartë e paraqet maja e Qyqavicës me lartësi 1, 117 m.Kjo komunë shtrihet rreth koordinantav gjeografike: 42° 44 48 V dhe 20° 47 19 L.

1.1 TE DHËNAT HISTORIKE TË KOMUNËS SË SKËNDERAJT

Komuna e Skënderajit është një vend i cili daton që nga kohrat e lashta Ilire që dëshmohet m dokumentacionin paraprak të arkivave dhe që ka një parahistori si: Runiku Lokalitet i Neolitit të hershëm dhe të ri, pastaj monumentet mesjetare Surigana: Kështjellë antike dhe mesjetare; monumenti mesjetar në Tushilë “Gjytet” (gërmadha) etj. Skënderaj është qendra e një krahine ndër me rezistueset, në gjithë trojet shqiptare. Populli i saj i ngulitur që nga lashtësia në këto troje, gjithmonë deri në ditët e sotme ishte i prirur që të mos nënshtorhet ndaj asnjë pushtuesi pa marrë parasysh fuqinë e tij dhe gjithëherë duke pasur për motiv mbrojtjen e trojeve të tyre etnike. Pra, Skënderaj është një nga qendrat dhe trevat më kryengritëse në të gjitha trojet shqiptare. Ai u ngrit kundër Perandorisë Osmane dhe me 1891, ia bëri rrafsh me tokë Sarajin që po ngrehte për administratën turke, pikërisht në Skënderajin e sotëm. Në vitin 1912, Hasan Prishtina, edhe ky bir Drenice, me prejardhje nga Palaci i Skënderajit, mbajti fjalimin mobilizues pranë Kullës së Ahmet Delisë së Prekazit, trimat e të cilit fshat, në periudha të ndryshme kohore ndëruruan ritmin monoton të historisë dhe mbeten në kujtesën e kombit si shembujt më tipik se si vdiset për t’u bërë tapia e kësaj toke. Më 1912, Ahmet Delia i kundërvihet hordhivë të armatosura serbe që terrorizonin fshatin me ç’rast vret disa ushtarë serbë. Nga kjo ditë, për kohë të gjatë ndëruron kursi i sjelljes së policisë dhe ushtrisë serbe ndaj popullatës së pafajshme. Nuk hyhet kohë e pa kohë për të bastisur shtëpitë shqiptare. Por jo vetëm Prekazi sfidoi pushtuesit e sidomos hegjemoninë serbe. E gjithë Drenica ishte log betejash në krye me Azem e Shotë Galicën në vitet e njëzeta kur hegjemonia serbe po bënte përpjekje të shpërngulë me terror shqiptarët për ta konolizuar atë me sllavë, e gjithë Drenica u përgjak në vitin 1945 ngase bijt e sajë po kuptonin fare mirë se po bëhej tradhëti dhe trojet shqiptare prapë po ngelnin nën thundrën sllave. Më 1981, Tahir Meha, i po këtij fshati, tregon se si i dilet zot vatanit . Ngujohet në kullë dhe lufton derisa me tanke ushtria moderne jugosllave ia bën rrafsh me tokë kullën e Emin Latifit – gjyshit të tij dhe bashkëlufëtëtarit të Azem Galicës.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) është themeluar në këto troje dhe me të vërtetë Skënderaj konsiderohet treva më kryengritëse e Kosovës dhe trojeve tjera shqiptare. Operacionet ushtarake të ushtrisë serbe në mars të vitit 1998 në Prekaz kundër udhëheqësit të UÇK Adem Jashari paraqesin fillimin e luftës së përgjakshme kundër pushtuesve serb. Adem Jashari, Komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) përfundimisht i bëri të ditur botës se sa është i lidhur për truallin dhe çfarë sakrificash në përmasa mitike është në gjendje të përballojë për lirinë e atdheut njeriu shqiptar e në veçanti shqiptari i Drenicës.

- **Plani i kompleksit me pozitën e Skënderajit**

Kompleksi memorial "Adem Jashari" përfshinë pjesërisht territorin e Prekazit dhe territorin e Skënderajit.

Sipërfaqja e përfshirë e kompleksit në kuadër të kufirit kadastral të Prekazit SI=23.50.67ha.

Kufiri i Kompleksit Memorial është caktuar me Planin Urbanistik të Kompleksit Memorial Kompleksi i Jashareve në Prekaz është potenciali kryesor i turizmit historik dhe vlerave të veçanta historike. Ky kompleks vizitohet nga vizitorë të të gjitha trojeve shqipëtare, si dhe vizitohet nga turistë të huaj për të njohur rezistencën heroike kombëtare të popullit shqipëtar.

- **Topografia**

Territori i Komunës së Skënderajit ka konfiguracion kodrinoro-malorë me lartësi mbidetare mesatare prej 500–700 m. Niveli më i ultë paraqitet me lartësi mbidetare 470 m dhe është në fshatin Brojë, ndërsa nivelin më të lartë e paraqet maja e Qyqavicës me lartësi 1 117 m. Siq edhe po shihet në hartë, pjesën më të madhe të Skënderajit e dominojnë kuotat me nivel mbidetar (600-700) m. Ka reliev të butë, përshkohet me lugina lumenjësh të vegjël, kryesisht dominon klimë e mesme kontinentale që karakterizohet me dimëra të ashpër, vera të thata me temperatura të larta e reshje të pakta, ndërsa ka një florë dhe faunë të pasur.

- **Hidrografia**

Terreni në të cilin është komuna e Skënderajit i takojnë slivit të Detit Adriatik. Në lindje të komunës rrjedh lumi Klina, rrjedha e majtë e Drinit të Bardhë. Në lindje dhe juglindje rrjedhin lumenjtë Sitnica dhe Drenica. Lumi Klina buron në fshatin Kuqicë dhe përshkon territorin në aksin veri jug dhe kalon nëpër tërë territorin e Komunës si dhe në qendrën e qytetit të Skënderajit me një rrjedhë të ngadalshme, me një thellësi mesatare dhe një gjatësi prej 40 km.

- **Numri i popullsisë**

Në Komunën e Skënderajit sipas vlerësimeve jetojnë 51,317 banorë, që përbëjnë rreth 3% të banorëve të Kosovës. Nga numri i përgjithshëm të banorëve në komunë, 6612 (rreth 13%) jetojnë në zonën urbane, dhe 87% që jetojnë në zona rurale. Regjistrimi i mëparshëm dhe vlerësimi i popullsisë i kryer nga autoritetet e Kosovës përfshin numrin e përgjithshëm të popullsisë, ndërsa të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 përfshijnë vetëm popullsinë rezidente. Duke marrë këtë konsideratë mungesën e konsistencës, është e vështirë të jepet një vlerësim i saktë për numrin e rritjes së popullsisë gjatë viteve. Përveç numrit të banorëve rezident, vlerësohet se janë edhe rreth 15.000 persona nga Skënderaji të cilët jetojnë jashtë vendit.

- **Ekonomia**

Kosova ka një zhvillim jo të balancuar ekonomik nëpër komuna si pasojë e zhvillimit joproporcional infrastrukturor, potencial të ndryshueshëm të zhvillimit bujqësor, turistik, industrial, tregtar, zhvillimeve jo mirë të menaxhuara të kapaciteteve e resurseve humane dhe cilësisë së jetës së qytetarve etj. Zhvillimi jo i balancuar në aspektin ekonomik shpreh çështjen e papunësisë, shkallën e ulët të të ardhurave personale, mungesën e investimeve nëpër sektor, si dhe investimet kapitale në lëmi të ndryshme. Të ardhurat për kokë banori - dallimet në të ardhura ndërmjet komunave janë të mëdha, banorët e komunave më të zhvilluara fitojnë gati tre herë më shumë se ata në ato të pazhvilluarat. Përderisa, vlera mesatare e shkallës së papunësisë për Kosovën është 34.07%.

Komuna e Skënderajit ka shkallën e papunësisë rreth 65-75%. Komunë relativisht e varfër, e karakterizuar me munges të investimeve në të gjitha fushat zhvillimore që nga koha e Jugosllavisë. Bujqësia mbetet themeli i ekonomisë në këtë komunë, mirëpo toka e punueshme nuk është shfytëzuar aq shumë.

1.)Per Drejtorin e Drejtorisë e Gjeodosisë dhe Kataster.

Drejtor sa keni informata si drejtorat sa është realizuar në implementimin e projektit të ridentertimit të tokave në komunën tonë gjegjësisht është fjala për projektin në realizim në fsh Polac,Llaushë dhe pjesen e fshatit të ri në hyrje Skenderajit.

2.)Per Drejtorin e Bujqësis dhe Zhvillimit Rural.

Drejtor a keni në planë konkret në perkrahje për sumvencionimin e fermerve e qumshetit në liter,një kërkesë e kahmotshve të fermerve(prodhues të qumështit,si dhe duke e pasur parasysh se shumica e komunave në Kosovë tashmë po i sumvencionojnë.

3.)Per Drejtorin për Urbanizem

Drejtor a planifikoni të filloni në punimet e mbetura gjysmë të asfaltimit të disa rrugëve brenda fshatit si tek lagjet Gruda, e Gjamisë,Veliu,Koci të cilat janë të trasuara në zhavorë dhe të cilat janë mbetura të pakryera nga vitet 2023/24.

Me respekt

Afrim Kabashi këshilltar komunal(NSD)